

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6128
E enjte, 1 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Që dy ditë radhazi asnjë i vdekur në Kosovë nga Covid-19

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

23 VJET NGA PROTESTA STUDENTORE E 1 TETORIT E VITIT 1997

Lëvizja Studentore e '97-s i dha shpirt UÇK-së



Historianët e kanë vlerësuar ngjarje shumë e rëndësishme në historinë më të re të Kosovës protestën studentore të 1 tetorit të vitit 1997. Në 23-vjetorin e kësaj proteste, profesorët universitarë të historisë,

Muhamet Mala dhe Ibrahim Gashi, për gazetën "Epoka e re" kanë thënë se kjo ngjarje ka pasur ndikim shumë të madh në rrjedhat politike. Sipas tyre, kjo lëvizje ishte krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare të Kosovës e

cila i dha fund lëvizjes paqësore. Edhe udhëheqësit e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 këtë ngjarje e kanë vlerësuar shumë të rëndësishme në historinë më të re të Kosovës

NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT PËR PROCESIN ZGJEDHOR

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) që disa vjet ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet që merren me proceset zgjedhore. Të mërkurën, po në këtë kontekst të punës, është nënshkruar memorandumi në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,



bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional sa i përket procesit zgjedhor

Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës dhe Komisionit të Pavarur për Media, për përfundimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional sa i përket procesit zgjedhor

PUNËTORËT
TEKNIKË
SHËNDETËSORË
KËRKOJNË
TË PËRFSHIHEN
NË PAKON
EMERGJENTE

FAQE 7



AKTUALE



DEBATI TRUMP - BIDEN:
RETORIKË E ZJARRTË DHE
SULME PERSONALE F. 11

BE-ja: ASOCIACIONI
TË KRIJOHET NË BAZË
TË OPINIONIT TË GJYKATËS
KUSHTETUESE F. 2

MINISTRI QUNI VIZITOI
AKADEMINË USHTARAKE TË
TURQISË F. 3

AMBASADORI GJERMAN BËN
THIRRJE QË TË VOTOHET
PROJEKTILIGJI PËR RIMËKËMBJE
EKONOMIKE F. 5

EKONOMI



BQK-ja PARASHIKON
KËTË VIT RËNIE EKONOMIKE
PREJ 7.2-PËRQINDËSH F. 9

NGA 12 TETORI
FILLON INTERVISTIMI I 21
DËSHMITARËVE PËR
PRIVATIZIMIN NË KOSOVË F. 8

SPORT

LLAPI REGJISTROI HUMBJEN E
KATËRT RRESHT, '89-SHI
MPOSHTI PRISHTINËN F. 13

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja: Asociacioni të krijohet në bazë të opinionit të Gjykatës Kushtetuese



PRISHTINË, 30 SHTATOR - Bashkimi Evropian ka sqaruar se qëndrimi i saj mbetet se të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të zbatohet dhe se në zbatimin e marrëveshjes për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe duhet të merret parasysh edhe mendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. "I takon Kosovës që të propozojë si të ecet përpara, me zbatimin e marrëveshjeve të vitit 2013 dhe 2015, duke marrë parasysh mendimin e Gjykatës Kushtetuese", ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, kur u pyet se "a duhet të zbatohet marrëveshja për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës". Më herët, Stano kishte thënë se Kosova me këto marrëveshje ka

marrë obligime me vullnet të mirë dhe duhet t'u përmbahet atyre obligimeve. "BE-ja dhe shtetet anëtare presin nga palët që t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet nga e kaluara. Çështjet e hapura nga marrëveshjet e mëparshme duhet të adresohen paralelisht me negociatat në vazhdim e sipër për marrëveshjen gjithëpërfshirëse", ka deklaruar Stano, teksa iu përgjigj pyetjeve lidhur me atë se a do të bisedojnë palët për krijimin e asociacionit gjatë bisedimeve në Bruksel. "Asociacioni është një mjet i krijuar në vitin 2013 për t'i adresuar nevojat e komunitetit joshumicë serb në Kosovë. Si pjesë e negociatave për marrëveshjen gjithëpërfshirëse është thelbësore që të adresohen në përgjithësi aranzhimet për komunitetin joshumicë. Në vitin 2013, Kosova ka hyrë në

marrëveshje për ta themeluar asociacionin e komunave serbe. Kjo marrëveshje është bërë me vullnet në mirëbesim nga të gjitha palët e përfshira. Nuk është anuluar apo tërhequr asnjëherë. Në fakt, marrëveshja e vitit 2013 është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës me shumicën e 2/3 të votave. Duke bërë këtë, Kosova ka marrë obligime ndërkombëtare për ta zbatuar këtë marrëveshje", ka thënë zëdhënësi i BE-së. Zëdhënësi i BE-së, duke shprehur qëndrimin e bllokut evropian, ka shtuar se "i takon Kosovës që ta propozojë rrugën tutje për zbatimin e kësaj marrëveshjeje". Stano ka thënë se "vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me asociacionin rregullisht është keqinterpretuar". "Gjykata asnjëherë nuk ka thënë se asociacioni nuk mund të

themelohet. Prandaj, presim nga Kosova që ta respektojë obligimin që ka marrë përsipër në dialog. Çështja e aranzhimeve për komunitetin joshumicë -asociacionin - duhet të adresohet si pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse ashtu siç kishin rënë dakord liderët në takimin e tyre të parë në korrik të vitit 2020 dhe ishte konfirmuar në raundin e fundit më 7 shtator", është shprehur Stano. Krijimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe tash e një muaj është bërë temë e kundërshtimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përderisa Beogradi ka insistuar që për këtë temë të diskutohet në dialog dhe ajo të zbatohet sa më shpejt, pala e Kosovës ka refuzuar një gjë të tillë. Por, Beogradi ka shprehur mospajtime edhe për propozimet që asociacioni të

themelohet në bazë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Madje, në takimin e fundit të Kosovës dhe Serbisë në nivel ekspertësh në Bruksel, Beogradi e kushtëzoi vazhdimin e dialogut me këtë çështje.

Në prill të vitit 2013, Kosova dhe Serbia, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Brukseli, patën arritur marrëveshjen e parë të Brukselit, ku në bazë të kësaj marrëveshjeje parashihej edhe krijimi i një asociacioni/bashkësie të komunave me shumicë serbe. Sipas marrëveshjes, asociacioni do të krijohet me statut dhe do të themelohet mbi po të njëjtat baza sikurse statuti ekzistues i asociacionit të komunave të Kosovës si, për shembull, do të ketë kryetar, zëvendëskryetar asambleje dhe këshill.

Më 2015 po në kuadër të dialogut të Brukselit palët arritën marrëveshje mbi parimet për krijimin e këtij asociacioni, marrëveshje e cila ende nuk është jetësuar, përkundër insistimit të Beogradit zyrtar.

Në tetor të vitit 2015 kjo marrëveshje u dërgua për interpretim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga presidentja e atëherëshme e Kosovës, Atifete Jahjaga.

Gjykata Kushtetuese, në aktgjykimin e nxjerrë në dhjetor të vitit 2015, tha se Marrëveshja për Asociacionin në 23 pika të saj nuk është në harmoni me Kushtetutën e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se akti juridik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe statuti që zbaton parimet, për të qenë në pajtueshmëri me frymën e Kushtetutës, duhet t'i plotësojë standardet kushtetuese. Në fakt, është e diskutueshme që asociacioni nuk bazohet në multietnicitet, por bashkon komuna në të cilat një komunitet etnik është shumica. Janë gjithsej dhjetë komuna me shumicë serbe në Kosovë.

Hoti mban takim pune me kabinetin qeveritar

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Kryeministri Avdullah Hoti ka mbajtur të mërkurën takim pune me kabinetin qeveritar. Ai në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se mbajtja e këtij takimi ka të

bëjë me realizimin e programit të qeverisë në 100-ditëshin e parë dhe aktivitetet e parapara, me theks të veçantë në Pakon për Rimëkëmbje, planin legjislativ dhe planin investiv 2021-25. "Ne po përballemi

me sfida të rëndësishme dhe ky mobilizim i kabinetit është një mundësi për të hartuar një rrugë të qartë drejt një Kosove që i kthehet normalitetit, më të zhvilluar dhe me prosperitet për të gjithë pa dallim", ka shkruar Hoti.



Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit KQZ, PSh, PK, GJK, PZAP dhe KPM

Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit për procesin zgjedhor

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) që disa vjet ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet që merren me proceset zgjedhore. Të mërkurën, po në këtë kontekst të punës, është nënshkruar memorandumi në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës dhe Komisionit të Pavarur për Media, për përforcimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional sa i përket procesit zgjedhor



**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Drejtuesit e gjashtë institucione të Republikës së Kosovës (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Prokurori i Shtetit, Policia e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës dhe Komisioni i Pavarur për Media) nënshkruan të mërkurën memorandumin e bashkëpunimit për procesin zgjedhor. Në këtë ceremoni të organizuar nga Demokraci dhe Zhvillim (D4D) mori pjesë edhe kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, e cila mbajti një

fjalë rasti. Ajo ka thënë me këtë rast se kjo marrëveshje është tregues i qartë i vullnetit të përbashkët të të gjitha institucioneve për të bashkëpunuar me qëllim që proceset zgjedhore të zhvillohen në përputhje me ligjin, por edhe të reagojnë kur cenohet integriteti i tyre dhe e drejta e votës. “Sipas Kushtetutës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka barrën kryesore për organizimin e proceseve zgjedhore në Republikën e Kosovës, por jemi të vetëdijshëm se bashkëpunimi ndërinstitucional është i domosdoshëm për t’u shërbyer zgjedhjeve të lira dhe

demokratike”, ka thënë Daka. Edhe drejtuesit e tjerë të institucioneve nënshkruese të këtij memorandumi u shprehën për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor. Qëllimi i memorandumit është i shprehur në nenin 1 të tij. Në këtë nen thuhet se qëllimi i këtij memorandumi është ngritja e nivelit të bashkëpunimit dhe

koordinimit të vazhdueshëm institucional për parandalimin e shkeljeve ligjore si dhe hetimin, ndjekjen dhe gjykimin efikas të të gjitha rasteve që bien ndesh me ligjet, rregullat zgjedhore apo veprat penale kundër të drejtave të votimit në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Gjatë kësaj ceremonie u prezantuan edhe të gjeturat e punimit “Vendosja e drejtësisë

në zgjedhje”. Ndër të tjera, u theksua se numri i ankesave është dukshëm më i lartë në zgjedhjet lokale se në zgjedhjet parlamentare. Kjo për shkak se në zgjedhje lokale çdo komunë konsiderohet si garë në vete dhe mund të kontestohet si e tillë, dhe numri i subjekteve politike dhe kandidatëve që garojnë është shumëfish më i lartë se në zgjedhjet parlamentare.

Ministri Quni vizitoi Akademinë Ushtarake të Turqisë

ANKARA, 30 SHTATOR (ER) - Në vazhden e aktiviteteve në kuadër të vizitës zyrtare katërditore në Republikën e Turqisë, me ftesë të homologut të tij, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, sot ka realizuar vizitën në Akademinë Ushtarake Turke, ku është pritur nga dekani i saj, prof. dr. Gultekin Yildiz dhe komandanti i Regjimentit Studentor të Akademisë, gjeneralbrigade Gultekin Yarali.

Gjatë takimit, ministrin Quni nikoqirët e njoftuan me strukturën organizative, sistemin arsimor, misionin, kapacitet akademike, qëllimin dhe detyrat kryesore të akademisë. Gjithashtu, ata e njoftuan edhe me të arriturat e kadetëve të FSK-së që studiojnë aktualisht në këtë akademi.

Nga ana e tij, ministri Quni nikoqirët i përgëzoi për të arriturat e akademisë ushtarake turke duke shprehur

falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për përkushtimin e tyre edhe në aftësimin sa më cilësor profesional dhe akademik të kadetëve tanë të cilët studiojnë aktualisht në këtë akademi.

Pas takimit me lidhshpimin e akademisë, ministri Quni realizoi takimin me kadetët e FSK-së që studiojnë në këtë akademi. Nga ta, ai u njoftua me rezultatet e tyre, kushtet e studimeve, sfidat si dhe preokupimet e tyre. Me këtë rast, ministri Quni përgëzoi kadetët tanë për sukseset e arritura dhe vendosmërinë e përkushtimit të tyre për të arritur rezultate sa më të mira. Ai ua rikujtoi se, përveç privilegjit si kadetë-studentë, “keni edhe përgjegjësinë e ambasadorëve të shtetit dhe kombit si dhe jeni përfaqësuesit e vlerave të identitetit të ushtarakut të denjë të Kosovës”, prandaj i inkurajoi të vazhdojnë të kultivojnë dhe t’i ngrahin sa



më lart këto vlera në ambientin studimor shumëkombësh të akademisë përkatëse. Akademia Ushtarake Turke është akademi ushtarake katërvjeçare dhe pjesë e Universitetit Kombëtar të

Mbrojtjes së Republikës së Turqisë. Misioni i saj është zhvillimi psiko-fizik dhe akademik-profesional i kadetëve të ushtrisë turke dhe mbi 20 shteteve aleate dhe miqësore të saj nga regjione dhe kontinente të ndryshme të

botës. Në kuadër të marrëveshjes dhe bashkëpunimit bilateral të ministrive dhe forcave respektive, që nga viti 2011, krahas kadetëve të tjerë, në këtë akademi studiojnë edhe kadetët e FSK-së.



23 vjet nga protesta studentore e 1 tetorit e vitit 1997

LËVIZJA STUDENTORE E '97-s I DHA SHPIRT UÇK-së

Historianët e kanë vlerësuar ngjarje shumë e rëndësishme në historinë më të re të Kosovës protestën studentore të 1 tetorit të vitit 1997. Në 23-vjetorin e kësaj proteste, profesorët universitarë të historisë, Muhamet Mala dhe Ibrahim Gashi, kanë thënë për gazetën “Epoka e re” se kjo ngjarje ka pasur ndikim shumë të madh në rrjedhat politike. Sipas tyre, kjo lëvizje ishte krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare të Kosovës e cila i dha fund lëvizjes paqësore. Edhe protagonistët e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë vlerësuar këtë ngjarje shumë të rëndësishme në historinë më të re të Kosovës

e cila kishte filluar shumë më herët. Në fakt, lëvizja çlirimtare në Kosovë çdoherë i ka pasur dy komponentë. Komponenti i parë ka qenë një lloj rezistence ushtarake që nga përfundimi i Luftës së

Dytë Botërore në kohën e lëvizjes nacional demokratike çlirimtare. Në këtë kuptim ajo ka vazhduar në vitin 1968 me protesta dhe më 1981 po ashtu, për të ardhur deri te lëvizja studentore, e cila e ka

plotësuar këtë lëvizje”, ka thënë Mala. Ai ka vlerësuar se kjo lëvizje ishte revolucionare në kuptimin pozitiv të fjalës. “Kjo lëvizje ishte revolucionare në kuptimin pozitiv të fjalës, mirëpo i



**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Lëvizja Studentore e '97-s është vlerësuar krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare i Kosovës nga historianët e njohur të Kosovës. Në 23-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997, profesorët universitarë të historisë, Muhamet Mala dhe Ibrahim Gashi, kanë thënë për “Epokën e re” se ndikimet e kësaj

ngjarje ishin të mëdha në rrjedhat e proceseve të mëvonshme politike. Ata kanë deklaruar se kjo lëvizje solli një kthesë historike në procesin e lëvizjes për çlirimin e Kosovës.

Profesor Muhamet Mala ka vlerësuar se Lëvizja Studentore e '97-s ishte krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare. “Në përvjetorin e 23-të të Lëvizjes Studentore, mendoj se kjo lëvizje ka qenë një krahu intelektual i lëvizjes çlirimtare

mungonte edhe krahu intelektual. E krahu intelektual është pikërisht ajo forca lëvizëse e cili e ka çuar këtë proces përpara”, ka thënë ai.

Sipas historianit Mala, ndikimi i kësaj ngjarje në proceset e mëvonshme ishte i madh. “Mendoj se Lëvizja Studentore i ka dhënë shpirt edhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u ka dhënë shpirt të gjitha proceseve të tjera historike në kuptimin pozitiv të fjalës. Pra, sistemi i funksionimit të lëvizjes çlirimtare në Kosovë ka qenë komplementar dhe plotësues. Në njërën anë, një krah i fortë ushtarak dhe, në krahun tjetër, ai intelektual. Pa bashkimin e këtyre dy elementeve nuk kemi mundur të arrijmë aty ku jemi sot. E pikërisht elementi i Lëvizjes Studentore ka qenë ai që e ka zgjuar dhe i ka dhënë një impuls kësaj lëvizje”, ka deklaruar profesori Mala. Sipas tij, Lëvizja Studentore e '97-s solli ide dhe ideale të reja në rugën e çlirimit të Kosovës. “Ndikimet e kësaj ngjarje kanë qenë shumë të mëdha, sepse kuptohet se Lëvizja Studentore e përbën atë elementin më elitare të secilës shoqëri, sepse janë gjenerata të reja të cilat kanë sjellë frymë të re, kanë sjellë ide dhe ideale të reja. Në këtë kuptim padyshim se Lëvizja Studentore është një kthesë historike në procesin e lëvizjes çlirimtare të Kosovës”, ka vlerësuar Mala.

Profesori tjetër universitar i historisë, Ibrahim Gashi, ka folur për “Epokën e re” për ndikimet e kësaj ngjarje. Ai ka deklaruar se protesta e 1 tetorit e vitit 1997 ka shënuar fundin e lëvizjes paqësore. “Protesta studentore e vitit 1997 është një ngjarje e shënuar në historinë më të re të Kosovës. Kjo dhe këto protesta kanë lëvizur procesin e lëvizjes për çlirim dhe pavarësi të vendit një hap më tutje. E them kështu sepse këto protesta shumica e autorëve perëndimorë i konsiderojnë si fundin e lëvizjes së rezistencës paqësore”, ka thënë Gashi. Ai ka deklaruar se pas këtyre protestave fillon të dalë në plan të parë lëvizja aktive, lëvizja e armatosur për çlirimin e Kosovës. “Në fakt, autori Hovort Clark protestën e 1 Tetorit e quan si fundin e veprimit joviolent. Sipas tij, protesta shpërfaq në njëfarë mënyre dështimet e lëvizjes paqësore për ta çuar përpara çështjen e Kosovës. Pra, pas këtyre protestave fillon të dalë në plan të parë lëvizja aktive, pra lëvizja e armatosur për çlirimin e Kosovës”, ka thënë Gashi.

Edhe protagonistët e protestës studentore të 1 tetorit të vitit



1997 e kanë vlerësuar këtë ngjarje shumë të rëndësishme në historinë më të re të Kosovës. Në përvjetorët e tjerë ata kanë vlerësuar se Lëvizja Studentore ka arritur qëllimin, duke ngritur një popull të tërë të pasivizuar e të pashpresë. Ish-kryetari i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, pati thënë se studentët me protestat e tyre arritën t'ia kthejnë shpresën popullit të Kosovës. “Kush do të besonte se rruga tatëpjetë e lagjes Velania në Prishtinë do të ishte vendi që do ta thyente heshtjen tonë e do të fillonte zëri që do të dëgjohej gjithandej. Rezistenca filloi, heshtja u thye, kthesa u arrit”, ka shkruar ai. Sipas Dugollit, kjo protestë e ngriti popullin e pasivizuar. “Brezi studentor i '97-s ka arritur qëllimin, duke ngritur një popull të tërë të pasivizuar e të pashpresë, duke ia kthyer popullit shpresën dhe besimin se gjërat mund të bëhen dhe duhet të bëhen, por ky brez edhe sot, sikundër edhe brezat e tjerë, ka se çfarë t'i japë Kosovës dhe institucioneve të saj në të

gjitha sferat. Dëshmi është koha, 1 tetori është garancia”, ka kishte thënë Dugolli. Edhe Albn Kurti, protagonist i kësaj lëvizje, ka vlerësuar se ndikimi i kësaj proteste në rrjedhat e proceseve ishte i madh. “1 tetori e kishte një element gjenerik për të cilin ne studentët nuk ishim të vetëdijshëm. Ishte edhe përsheptues i çlirimit. Gjithçka filloi të ecë dhe të lëvizë më shpejt”, pati deklaruar Kurti. Edhe dy protagonistët e tjerë të Lëvizjes Studentore, Muhamet Mavraj dhe Driton Lajçi, në çdo përvjetor kanë theksuar se organizimi studentor i '97-s ka pasur efekt shumëdimensional dhe ka qenë një mesazh për ta zgjuar nga gjumi klasën e atëhershme politike. “Në aspektin njerëzor është mbytur frika, kurse në aspektin politik gjërat kanë lëvizur nga vendi. Ka qenë një mesazh për t'i zgjuar nga gjumi edhe strukturat e atëhershme politike. Ka qenë edhe një largim i frikës, mjegullës dhe paqartësive të kohës kur Kosova ndodhej në


një okupim klasik, në një shkelje të vrazhdë të të drejtave të njeriut, në dhunë të përditshme individuale dhe masive nga forcat policore, ushtarake dhe administrata e dhunshme e instaluar në territorin e Kosovës”, është shprehur Driton Lajçi. Ndërkaq Muhamet Mavraj ka thënë se me këtë datë ndahen epokat e Kosovës. “Nga politika pasive, gradualisht kalohet në rezistencë aktive. Pra, Lëvizja Studentore është fazë e ndërmjetme e dy politikave të kundërta, një fazë kalimtare. Kështu, hap pas hapi, shkuam edhe drejt luftës çlirimtare dhe fundit të sundimit të Serbisë në Kosovë. Ky fund është rezultat, gati njëshekullor, i brezave tanë. Më 1 tetor është mposhtur frika e Kosovës, ka rënë miti i frikës dhe secili shqiptar është ndier mirë, më solidar me tjetrin. Me një fjalë, u rikthye vlera tradicionale. Përvjetorët e 1 tetorit ushqejnë një impuls krenarie, natyrisht, por na bëjnë t'i kujtojmë shumë shokë tanët dëshmorë”, ka thënë Muhamet Mavraj.

Ambasadori gjerman bën thirrje që të votohet Projektligji për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka bërë thirrje që të votohet në Kuvend Projektligji për rimëkëmbje ekonomike. Në një postim në llogarinë e vet “Twitter”, ai ka thënë se lufta kundër efekteve negative në ekonomi të shkaktuara nga pandemia është përgjegjësi e përbashkët dhe kërkon angazhim të përbashkët. “Në këtë aspekt është mjaft dëshpëruese dhe, sipas njohurive të mia, edhe rast unik në Evropë se për herë të pestë në Kuvendin e Kosovës nuk është arritur marrëveshje për draftligjin e rimëkëmbjes ekonomike”, ka shkruar ai, duke shtuar se partitë politike duhet të bëjnë kompromis për këtë çështje. “Ajo që duhet urgjentisht nga të gjithë përgjegjësit është fryma e kompromisit. Qytetarët e Kosovës me të drejtë e presin këtë”, ka shkruar Rohde.

Nga sot do të fillojë aplikimi për patentshofer ndërkombëtar

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka njoftuar se nga sot, më 1 tetor, do ta fillojë aplikimin për patentshofer ndërkombëtar. Bëhet me dije se aplikimi do të bëhet në të gjitha qendrat për pajisje me dokumente, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2020 për Përcaktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Procedurës së Lëshimit të Patentë Shoferëve Ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës.



Komuna e Deçanit: Veprimet e fundit të arrestimit nga Gjykata Speciale, cenim i të drejtave dhe lirive të njeriut

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

DEÇAN, 30 SHTATOR - Të mërkurën në zyrën e kryetarit të Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, është mbajtur një takim me përfaqësuesit e Shoqatave të Dala nga Lufta e UÇK-së si dhe me Shoqatën e të Burgosurve Politikë, ku është diskutuar rreth arrestimeve të fundit të krerëve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. "Komuna e Deçanit me shqetësim të madh po i përcjell zhvillimet e fundit në Kosovë, ku po arrestohen luftëtarët e lirisë, të cilët tërë

jetën e tyre ia kanë kushtuar lirisë, duke sakrifikuar gjithçka për çlirimin e Kosovës nga pushtimi shekullor i Serbisë. Përkujtojmë me të drejtë se qëllimi i të gjithë luftëtarëve të lirisë ishte dhe është edhe sot çlirimi dhe ndërtimi i paqes dhe perspektivës në këtë vend", thuhet në njoftimin e Komunës së Deçanit.

Kjo komunë ka konsideruar se aktet e fundit të arrestimit nga Gjykata Speciale, janë cenim i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe ndërhyrje në rendin kushtetues të një shteti sovran për të cilin sakrifikuan shumë breza, e sidomos luftëtarët e UÇK-së. Më tej, thuhet se Komuna e Deçanit dhe



qytetarët e saj janë në mbështetje të luftëtarëve të lirisë të arrestuar ditë më parë dhe do të vazhdojnë të qëndrojnë pranë familjeve të tyre me mundësitë për

përkrahje deri në përfundimin e këtij procesi të padrejtë. Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj,

ka dalë të martën për herë të parë para Gjykatës së Dhomave të Specializuara në Hagë, nën dyshimet për pengim të drejtësisë. Gjatë paraqitjes së tij, Haradinaj ka përsëritur qëndrimin se nuk i njeh Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihet si Gjykata Speciale. "Nuk e kam njohur këtë gjykatë, nuk e njoh mandatin e skaduar që nga 2 gushti", ka thënë Nasim Haradinaj.

Dhomat e Specializuara kanë njoftuar se kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, do ta bëjë paraqitjen e parë para këtyre dhomave më 1 tetor.

Aktakuzë kundër 15 personave për falsifikim dokumentesh dhe krime financiare

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, kundër 15 të pandehurve për veprat penale: "Falsifikim i dokumenteve", nga neni 398 i KPRK-së, "Legalizimi i përmbajtjes së rreme", nga neni 395 i KPRK-së dhe "Shmangia nga Tatimi nga neni 313 i KPRK-së".

Të akuzuarit janë: N. L., B. A., A. K., B. R., B. A., B. Z., B. R., E. P., E. G., F. H., T. V., Sh. R., A. H., M. H dhe H. S. "Në periudhën kohore nga mesi i vitit 2018 e deri më 05.07.2019, në vazhdimësi janë përfshirë në aktivitetin kriminal të poshtëshënuar, ku i pandehuri N. L., duke vepruar si i vetëm, e në disa raste pas marrëveshjes paraprake në



bashkëkryerje me të pandehurin B. A., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material për vete, me anë të programit kompjuterik 'Corel Draw', me pajisje të sofistikuara fillimisht përpilonin dokumente publike të falsifikuara dhe të njëjtat më pas, edhe pse e kanë ditur se nuk janë të vërteta, ua kanë siguruar dhe shitur

personave të ndryshëm, më saktë tani të pandehurve: A. K., B. R., B. A., B. Z., B. R., E. P., E. G., F. H., T. V., Sh. R., A. H., M. H. dhe H. S, ku për të pandehurit e lartcekur janë siguruar prova nga të cilat vërtetohet se të njëjtët kanë aplikuar për vizë në Ambasadën Amerikane në Shkup, të cilat të dhëna, pas verifikimit dhe krahasimit, janë

vërtetuar se janë të falsifikuara dhe nuk korrespondojnë me të dhënat reale përkatëse", thuhet në njoftimin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Sipas po këtij njoftimi, po ashtu, tani i pandehuri N. L. ka deponuar mjete financiare në llogaritë përkatëse në bankat afariste të Kosovës, e pastaj ka realizuar transferime dhe tërheqje kesh. "Përshkrimi i pagesës për mall në kompani të ndryshme, e që në rastin konkret i pandehuri i lartcekur me qëllim është munduar të fshehtë apo t'i shmangët në tërësi pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, duke mos i përfshirë të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë e tij, gjendjen ekonomike dhe fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, ku i

pandehuri N. L. nga qarkullimi i përgjithshëm bankar në periudhën kohore 2014-2019 me bizneset e tij të potencuara në aktakuzë, e që nënkupton shumën e parave sipas të dhënave të gjetura lidhur me deponimet, transferet dhe importet e realizuara nga këto subjekte afariste, gjegjësisht shmangie të përgjithshme në TVSh dhe TAK në shumë prej 964 778.77 eurosh, me ç'rast i njëjti nuk i përfshin këto informata lidhur me të ardhurat e tij dhe në këtë mënyrë dëmton buxhetin e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin për media.

Në aktakuzë i është propozuar gjykatës që pas administrimit të provave dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të pandehurit, për veprat penale që akuzohen, t'i shpallë fajtorë dhe t'i gjykojë sipas ligjit.

Partitë politike kërkojnë nga KQZ-ja ta hartojë një udhëzues për procesin e ankesave

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në praninë e më shumë se pesëmbëdhjetë (15) përfaqësuesve të subjekteve politike si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, ka diskutuar për kryerjen e obligimeve të partive politike ndaj KQZ-së dhe impaktin e pandemisë Covid-19 në këto procese.

Drejtori i Zyrës për Regjistrim të Partive Politike, Yll Buleshka, u

uroi mirëseardhje përfaqësuesve të subjekteve politike, ndërsa tha se kjo tryezë është e nevojshme për faktin se gjatë pandemisë Covid-19 janë paraqitur pengesa për përmbushjen me kohë të detyrimeve të ndryshme që partitë politike kanë ndaj KQZ-së. Përfaqësuesit e partive politike u pajtuan që formularët e raportimeve të thjeshtëzohen duke ruajtur vetëm kërkesat ligjore.

Ndërsa lidhur me komunikimin e ndërsjellë, përfaqësuesit e partive politike theksuan që preferojnë opsionet e komunikimit përmes e-mailit dhe aplikacionit, duke përdorur si mjete sekondare të komunikimit edhe telefonin dhe rrjetet sociale (Viber, WhatsApp). Përfaqësuesit e partive politike, po ashtu, kërkuan që KQZ-ja ta hartojë një udhëzues për procesin e ankesave.



Që dy ditë radhazi asnjë i vdekur në Kosovë nga Covid-19

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Për të dytën ditë me radhë në Kosovë nuk u konfirmua asnjë rast i personit të vdekur nga Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit ka diagnostikuar 46 raste të reja pozitive me Covid-19 nga testimi i 580 mostrave. Numri total i rasteve pozitive është 15 620 raste nga 67 874 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 625 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 62 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 13 554 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 441.

Rastet pozitive në 24 orët e fundit janë nga komuna Gjilan 6 raste, komuna Podujevë 6 raste,

komuna Pejë 5 raste, komuna Prishtinë 5 raste, komuna Fushë-Kosovë 4 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Istog 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Ferizaj 2 raste, komuna Gjakovë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Shtime 2 raste dhe me nga një rast Dragash, Malishevë, Prizren dhe Viti.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, së bashku me ekipin e ekspertëve epidemiologjikë dhe mjekësorë të Institutit të Shëndetit Publik "Robert Koch Institute" dhe përfaqësuesit e Organizatës Botërore të Shëndetësisë vizituan të mërkurën spitalin e përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në Prizren, ku panë nga afër se si ky spital po e menaxhon situatën me pandeminë, si dhe punën dhe sfidat e stafit shëndetësor.

Po ashtu, ata vizituan edhe Qendrën Rajonale të Shëndetësisë Publike / QRSHP në



Prizren, degë e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), ku nga drejtori dr. Fadil Kryeziu u informuan për mbarëvajtjen e punës dhe për procesin e testimeve të Covid-19. "E

falënderova personelin shëndetësor për punën e palodhur në luftën kundër virusit. Ne po bëjmë përpjekje maksimale për t'i përmirësuar kushtet e stafit dhe ofrim të shërbimeve më të mira për pacientët. Përfaqësuesit

e institucioneve ndërkombëtare, të OBSH-së dhe të Institutit 'Robert Koch' të Gjermanisë, e vlerësuan lart punën tonë profesionale për menaxhimin e pandemisë", ka thënë ministri Zemaj.

Punëtorët teknikë shëndetësorë kërkojnë të përfshihen në pakon emergjente

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Punëtorët teknikë të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) të mërkurën kanë protestuar duke kërkuar që të përfshihen në listat e shtesave prej 300 eurosh të ndara nga Qeveria e Kosovës për rrezikshmëri në punë gjatë kohës së pandemisë.

Në protestë kanë marrë pjesë punëtorë nga administrata, receptionistët, vozitësit e autoambulancave, ata të sigurimit, shërbyesit e ushqimit, punëtorët e oksigjenit, të shërbimeve teknike si dhe ata të pastrimit.

Nezir Sopi, vozitës i



autoambulancës së Qendrës Emergjente, i cili ditën e mërkurë po protestonte në shenjë pakënaqësie që nuk është

përfshirë në Pakon Emergjente, tha se të gjithë vozitësit kanë bartur me qindra pacientë me Covid-19, duke shërbyer për

shëndetësorë, por edhe të stafit mbështetës. Si menaxhment kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që të gjithë punëtorët të përfshihen në këtë skemë të përfitimt. Në bashkëbisedim me qeverinë dhe Ministrinë e Shëndetësisë që do të shqyrtohen të gjitha mundësitë që të gjithë punonjësit e ShSKUK-së të përfshihen në këtë pagesë shtesë prej 300 eurosh", ka deklaruar Krasniqi.

Kosova po zbaton Pakon emergjente fiskale në vlerë të rreth 180 milionë eurove. Kjo pako, e cila kishte për qëllim t'i zbuste problemet ekonomike dhe sociale, ishte miratuar në muajin mars, pas konfirmimit të rasteve të para me koronavirus.

shëndetësorë, por edhe të stafit mbështetës. Si menaxhment kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që të gjithë punëtorët të përfshihen në këtë skemë të përfitimt. Në bashkëbisedim me qeverinë dhe Ministrinë e Shëndetësisë që do të shqyrtohen të gjitha mundësitë që të gjithë punonjësit e ShSKUK-së të përfshihen në këtë pagesë shtesë prej 300 eurosh", ka deklaruar Krasniqi.

Kosova po zbaton Pakon emergjente fiskale në vlerë të rreth 180 milionë eurove. Kjo pako, e cila kishte për qëllim t'i zbuste problemet ekonomike dhe sociale, ishte miratuar në muajin mars, pas konfirmimit të rasteve të para me koronavirus.

Komisioni Parlamentar për Shëndetësi viziton ShSKUK-në

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Komisioni Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Kosovës ka vizituar Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës për t'u njoftuar nga afër lidhur me punën e këtij institucioni, në veçanti lidhur me trajtimin e pacientëve të dyshuar dhe konfirmuar me Covid-19 si dhe për menaxhimin e pandemisë në përgjithësi.

Gjatë takimit deputetët u pritën nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi dhe anëtarët e bordit drejtues

të ShSKUK-së. Drejtori Krasniqi i njoftoi anëtarët e Komisionit Parlamentar për aktivitetet e kryera gjatë kësaj kohe, me fokusim në menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe i njoftoi për planet konkrete për përgatitjet për përbalimin e një vale tjetër të mundshme të pandemisë. Ai i ka njoftuar anëtarët e komisionit për rikthimin e shërbimeve specialistike dhe shërbimeve të tjera, po ashtu edhe për planet dhe projektet e tjera, në veçanti kërkoi përkrahjen e komisionit për funksionalizimin e Spitalit të Përgjithshëm në Podujevë, me buxhet dhe

staf shtesë. Në të njëjtën kohë, drejtori Krasniqi i informoi anëtarët e komisionit dhe kërkoi mbështetje për projektin e IVF-it dhe legjislacionin për transplantim të indeve dhe organeve. Anëtarët e komisionit shprehën vlerësimin e tyre dhe falënderuan menaxhmentin e ShSKUK për menaxhimin e pandemisë dhe ofruan mbështetjen e tyre të vazhduar.

Pas informatave dhe kërkesave që u drejtuan nga Bordi Drejtues dhe menaxhmenti i ShSKUK-së, deputetët e këtij



komisioni shprehën gatishmëri për t'i mbështetur institucionet shëndetësore në çdo sit-

uatë, me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të institucioneve shëndetësore.

ATK-ja nis komunikimin e drejtpërdrejtë me bizneset

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Pandemia Covid-19, përveç krizës shëndetësore, ka goditur mjaft shumë edhe sektorin e ekonomisë në vendin tonë, pasi që me rritjen e numrit të të infektuarve kemi pasur shtim të masave të kontrollit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat padyshim kanë shkaktuar humbje të mëdha në sektorin e ekonomisë. Sipas llogaritjeve nga të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, nga 18 marsi deri më tani kemi rënie prej 18 përqindësh të qarkullimit të bizneseve apo, shprehur në shifra, mbi 1 miliard euro.

Duke pasur parasysh ankesat e vazhdueshme të bizneseve rreth situatës së krijuar nga pandemia, e cila është duke iu pamundësuar kryerjen me kohë të obligimeve tatimore, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, me bashkëpunëtorë, si dhe me kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, kanë nisur komunikimin e drejtpërdrejtë me biznese.

Të mërkurën janë vizituar tri biznese: "Prishtina Mall", "Ciao

Berto", si dhe "Lesna", me të cilët është diskutuar për problemet të cilat tash e sa muaj janë duke e rënduar funksionimin e tyre si rezultat i efekteve që është duke vazhduar t'i japë pandemia.

Në këtë drejtim, drejtori Murtezaj ka thënë se ATK-ja do të mundohet që brenda kornizave ligjore të ofrojë mbështetje në mënyrë që ky recesion ekonomik i krijuar të tejkalohet dhe bizneset t'i rikthehen normalitetit të tyre, pasi qëndrueshmëria e tyre ekonomike është vitale për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ai më tutje tha se si institucion e kemi nisur këtë plan komunikimi me qëllim që të krijohet relacion tjetër me bizneset, duke prekur në problemet dhe vështirësitë që ata i kanë për implementim të Legjislacionit Tatimor, si dhe duke ngritur partneritet në luftimin dhe parandalimin e ekonomisë joformale.

Ndërkaq kryetari Rukiqi ka theksuar se janë këtu për të shikuar mundësi për lehtësira, sidomos tani kur shumica e



kompanive po ballafaqohen me krizë jashtëzakonisht të lartë nga pandemia. "Ne jemi duke punuar që të gjejmë forma të përkrahjes së drejtpërdrejtë financiare dhe është me rëndësi që të implementohet faza e fundit, që ka të bëjë me përkrahje të drejtpërdrejtë për kompanitë me pjesën e pagave", ka thënë Rukiqi.

E nga ana tjetër, përfaqësuesit e bizneseve u shprehën se këto vizita japin një shpresë që institucionet janë duke bashkëndierë gjendjen e tyre të rënduar ekonomike, duke theksuar se ndihma më e madhe që mund të vijë nga ATK-ja ka të bëjë me atë se çfarë mund të bëjmë që të ndihmohemi në

rrjedhën e keshit, në mënyrë që biznesi të jetë në gjendje të përforcohet dhe t'i mbajë punëtorët deri në rikthimin në normalitet.

Plani për vizita te bizneset do të vazhdojë të implementohet edhe gjatë ditëve në vijmë, sipas përzgjedhjeve që do t'i bëjë Oda Ekonomike e Kosovës.

Nga 12 tetori fillon intervistimi i 21 dëshmitarëve për privatizimin në Kosovë



EPOKA E RE **Albulena S. MAVARJ**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Kryesuesi i Komisionit Hetimor Parlamentar për Privatizimin, Hajrullah Çeku, ka folur të mërkurën rreth procesit të privatizimit në Kosovë, ndërsa ka bërë me dije se nga 12 tetori do të fillojë intervistimi i grupit të parë prej 21 dëshmitarëve që kanë pasur rol në privatizimin e ndërmarrjeve në vend. Çeku në një konferencë për media ka deklaruar se në këtë grup të dëshmitarëve bëjnë pjesë ish-ministra, ish-anëtarë të bordit të AKM-së dhe të AKP-së, si dhe ish-anëtarë të UNMIK-ut. "Kemi miratuar planin e punës për përdhën gjashtëmujore dhe

listën e dëshmitarëve për intervistim. Ne i kemi angazhuar katër komisionarë të jashtëm dhe kemi grumbulluar një numër të madh të dokumenteve. Në këtë fazë është intervistimi i dëshmitarëve. Janë diku 21 dëshmitarë. Në këtë grup bëjnë pjesë ish-ministra, ish-anëtarë bordi të AKM-së dhe AKP-së dhe ish-anëtarë të UNMIK-ut. Nga 12 tetori do të fillojë intervistimi i dëshmitarëve. Në grupin e dytë bëjnë pjesë pronarë të kompanive, ekspertë, gazetarë që e kanë monitoruar punën e privatizimit në Kosovë dhe ish-punëtorë të ndërmarrjeve", ka thënë Çeku, duke bërë thirrje që kushdo që ka dëshmi për procesin e privatizimit t'i sjellin në komisionin hetimor.

Reçica takon Schlee dhe Hoxhën, diskutojnë për politikën sociale

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur në takim drejtorin e fondacionit Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) në Kosovë, Rene Schlee dhe Brikenë Hoxha nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS). Reçica ka thënë se Schlee dhe Hoxha janë përkrahës të mëdhenj të nis-mave tona ligjore që tashmë janë në proces. "Veçmas punës së madhe që po bëjmë për reformën pensionale, për të

cilën u shprehën të gatshëm që do të na mbështesin përmes ekspertëve të tyre të kësaj fushe", ka thënë Reçica. Ai ka thënë se si ministër i MPMS-së u është tejet mirënjohës Shlees dhe Hoxhës për gjithë vullnetin dhe gatishmërinë e treguar për ta ndihmuar këtë ministri. "U pajtuam për ta thëlluar bashkëpunimin në funksion të jetësimit të politikave sociale që për qëllim kanë rritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë", ka deklaruar Reçica.



BQK-ja parashikon këtë vit rënie ekonomike prej 7.2-përqindësh



Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehi Mehmeti, ka raportuar para anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Transfere. Ai ka thënë se borxhi publik në vitin 2019 ka qenë 19.7 për qind. Mehmeti ka deklaruar se rritja ekonomike për vitin 2019 ka qenë 4.94 për qind, kurse në anën tjetër zëvendësguvernatori Sokol Havoll ka thënë se rënia ekonomike për këtë vit pritet të jetë 7.2-përqindësh

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 30 shtator - Komisioni për Buxhet dhe Transfere ka votuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2019. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehi Mehmeti, ka thënë se borxhi publik në vitin 2019 ka qenë 19.7 për qind. Po ashtu, Mehmeti ka deklaruar se rritja ekonomike për vitin 2019 ka qenë 4.94 për qind. Sipas tij, kreditë joperformuese shënuan nivelin

më të ulët dhe ishin në nivelin 2 për qind. "Tensionet ndërkombëtare kishin ndikim negativ edhe te ne. Ngadalësimi i rritjes rezultoi varësisht nga ndikimi i eksporteve. Rritja ekonomike për vitin 2019 ka qenë 4.94 për qind. Sipas ASK-së, kjo rritje është mbështetur nga sektori financiar, tregtia dhe sektori i sigurimeve. Lëvizja e çmimeve vazhdon të përcaktohet nga lëvizja e jashtme si pasojë e varësisë së importeve. Kreditë joperformuese shënuan nivelin

më të ulët ndonjëherë dhe ishin në nivelin 2 për qind. Sektori pensional - kthimi i investimeve 8 për qind, duke e rikuperuar edhe kthimin negativ që ishte në vitin paraprak 2018", ka deklaruar Mehmeti. Sipas tij, BQK-ja ka vazhduar avancimin e kapaciteteve profesionale me standardet ndërkombëtare. Ai ka folur edhe për punësimet, pozitat e shpallura brenda BQK-së. Mehmeti ka thënë se nuk ka pozita të jashtëligjshme në BQK. "Sa iu përket pozitave të

jashtëligjshme, asnjë pozitë e jashtëligjshme nuk është në BQK. Sipas strukturës janë aprovuar pozitat", u shpreh ai. Ndërkaq sa i përket Monegos dhe LuteCredit, ai ka thënë se BQK-ja ka zbatuar dispozitat ligjore me rastin e mbylljes së tyre. "Para licencimit të Monegos dhe LuteCredit janë marrë rekomandime nga institucionet. Po ashtu, janë paralajmëruar se nuk janë respektuar urdhrat", u shpreh ai. Po ashtu, Mehmeti ka thënë se BQK-ja nuk ka mandat apo të drejtë të ekzaminojë në banka pasi nuk mund të ndërhyjë në një kontratë të kredisë pasi ajo është nënshkruar nga klienti. "Sa i përket Monges dhe Lutecreditit, para se t'i japim licencën ne kemi marrë rekomandime nga të gjitha

institucionet, edhe nga AKI etj. Pasi kanë marrë licencën ata nuk iu kanë përmbajtur kriterëve duke dhënë kredi me 26 për qind. Ne i kemi paralajmëruar edhe para heqjes së licencës dhe ata nuk i kanë respektuar urdhrat tona. Për një vit rresht ne i kemi përcjell këto institucione. Ne kemi bërë të gjitha përgatitjet për t'u mbrojtur në arbitrazh", u shpreh ai. Kurse zëvendësguvernatori Sokol Havoll ka thënë se rënia ekonomike për këtë vit pritet të jetë 7.2 për qind. "Ne gjatë javës së kaluar kemi bërë rishikimet dhe rënia parashikohet të jetë -7.2 për qind projekcion për rënien ekonomike për vitin 2020, e cila mund të pësojë ndryshime gjatë muajve në vazhdim", ka deklaruar Havoll.

Bruto Produkti Vendor shënon rënie krahasuar me vitin e kaluar

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin e dytë të vitit 2020, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante. BPV-ja në tremujorin e dytë të këtij viti ka shënuar rënie për (-9.28 për qind), krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Sipas ASK-së, aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë

tremujor janë: ndërtimi (-47.08 për qind); tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor (-24.4 për qind); aktivitetet profesionale dhe administrative (-16.39 për qind); aktivitetet financiare dhe të sigurimit (-6.71 për qind); si dhe bujqësia, pyjet dhe peshkimi (-1.74 për qind). "Ndërkaq, rritje reale në këtë tremujor kishin aktivitetet ekonomike, si: industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, dhe furnizimi me ujë (19.8 për qind); informacioni dhe komunikacioni (29.6 për qind); aktivitetet pasurive të



paluajtshme (4.29 për qind); artet, argëtimi dhe çlodhja, dhe aktivitetet e tjera shërbimi (4.64 për qind); si dhe administrimi

publik, arsimit dhe shëndetësia (4.73 për qind. Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rënie janë: formimi i bruto kapitalit (-41.09 për qind); eksporti i shërbimeve (-62.93 për qind); dhe importi i mallrave dhe shërbimeve (-19.77 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se kishte rritje te: eksporti i mallrave (12.18 për qind); shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH (3.47 për qind); dhe shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (8.58 për qind).

Komuna e Mitrovicës ofron mbështetje për organizatat që kontribuojnë në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur

MITROVICË, 30 SHTATOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, së bashku me udhëheqësin e Njësisë për të Drejtat e Njeriut, Fitim Rama, kanë pritur në një takim drejtuesit e shoqatës "Zëri i Prindërve" në Mitrovicë, në krye me Bajram Qerkinaj, si dhe përfaqësuesen nga Qendra Burimore për Personat e Zhdukur në Prishtinë, Sara Salihu. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur me punën, aktivitetet dhe synimet që ka kjo shoqatë për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Gjatë

këtij takimi u kërku mbështetje nga ana e komunës që të bëhen thirrje te familjarët e të pagjeturve për kryerjen e ADN-së në mënyrë që identifikimi të jetë sa më i saktë pasi që, fatkeqësisht, edhe në qytetin e Mitrovicës ka pasur raste kur varrimi është kryer me identitete të gabuara. Me këtë rast, nënkryetari Faruk Mujka në emër të komunës ka ofruar bashkëpunim të plotë në këtë drejtim dhe, si pikë kontakti për familjarët e personave të pagjetur në Mitrovicë, ka caktuar zyrtarin Fitim Rama.



Kishte dhënë ryshfet 20 euro, gjykata e dënon me 1 500 euro gjobë

GJILAN, 30 SHTATOR (ER) - Gjykata Themelore në Gjilan ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit J. M., duke e gjykuar me 500 (pesëqind) euro gjobë dhe katër muaj burgim, i cili dënim, me pajtimin e palës, është zëvendësuar në të holla në shumën prej 1 000 eurosh.

I akuzuari më 28 maj 2020, rreth orës 22:30 minuta, në pikën kufitare "Dheu i Bardhë", në hyrje të Republikës së Kosovës, duke e drejtuar kamionin e markës "Volvo", ndalet për t'i kryer procedurat e kalimit të kufirit nga zyrtarët policorë e doganorë dhe gjatë kontrollit të përbashkët, të njëjtët gjejnë mall komercial të fshehur, të padeklaruar, produkte kozmetike dhe tekstil në kabinën e kamionit. Me këtë rast i akuzuari J. M.



ua ofron 20 euro zyrtarëve të lartpërmendur, duke iu thënë "mos e boni të madhe këtë punë dhe së bashku merrni 20 euro dhe pini diçka, hani", me ç'rast zyrtari policor i fotografon paratë dhe të njëjtat i konfiskon. Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale

"dhënie ryshfeti", vepër e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari për kryerjen e kësaj vepre, gjyqtari i Departamentit të Krimeve të Rënda ka shqiptuar dënim unik në shumën prej 1 500 eurosh.

Vihet gurthemeli i mbikalimit në Korroticë të Epërme

Drenas, 30 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovc dhe ministri i Infrastrukturës, Arben Abrashi, të mërkurën kanë vënë gurthemelin e mbikalimit për këmbësorë në fshatin Korroticë e Epërme në magjistralen M9. Qytetarët e pranishëm e mirëpritën fillimin e ndërtimit të mbikalimit, pasi është projekt që do ta rrisë sigurinë e tyre në komunikacion.

Kryetari Lladrovc ka falënderuar ministrin Abrashi për bashkëpunimin korrekt të deritanishëm, derisa ka theksuar se ky bashkëpunim do të vazhdo-

jë edhe në të ardhmen në projekte me rëndësi për qytetarët e Drenasit.

Gjithashtu, me ministrin Abrashi u bisedua për projekte si anashkalimet pranë mbikalimit në Komoran, projekt i cili do të fillojë së shpejti, për rrethrotullimin në Tërstenik, për zhvillimin e projektit të rrugës me katër korsi Skenderaj-Drenas-Komoran, për mundësitë e përfundimit të rrugës së bregut të Qyqavicës, si dhe për rrugët lidhëse me fshatra të komunave të tjera, por që kryejnë shërbime në Komunën e Drenasit.



Fillon rregullimi i dy rrugëve në fshatin Marali të Malishevës

MALISHEVË, 30 SHTATOR (ER) - Të mërkurën në fshatin Marali ka filluar rregullimi i dy rrugëve të këtij fshati, rruga "Mulla Selimi" dhe rruga "Naim Frashëri". Në fillimin e punimeve për rregullimin e këtyre rrugëve ishin të pranishëm, drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina dhe anëtar i Asamblesë Komonale nga ky fshat, Hashim Vrenezi, të cilët janë takuar edhe me banorë të

fshatit dhe i kanë uruar për rrugët e reja. Drejtori i Urbanizimit, Ahmet Morina, tha se "rregullimi i këtyre dy rrugëve, rreth 600 metra gjatësi, janë pjesë e investimeve të Komunës së Malishevës, në infrastrukturën rrugore në fshatra, përkatësisht në Marali dhe i uroj të gjithë banorët për rrugët e reja". "Ne jemi duke vazhduar realizimin e investimeve në infrastrukturë

në përgjithësi, në të gjitha vendbanimet dhe gradualisht jemi duke i përmbyllur planifikimet për investime në këtë vit, pjesë e së cilës janë edhe këto dy rrugë", ka thënë Morina.

Rruga "Mulla Selimi" është e gjatë 500 metra, ndërsa rruga "Naim Frashëri" është e gjatë 100 metra, ndërsa hapja, zgjerimi dhe rregullimi i tyre mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Debati Trump - Biden: Retorikë e zjarrtë dhe sulme personale

WASHINGTON, 30 SHTATOR - Kandidati presidencial demokrat në Shtetet e Bashkuara, Joe Biden dhe presidenti Donald Trump i kaluan 90 minuta në debatin e tyre të parë presidencial, me ndërprerje të fjalës dhe përplasje verbale, duke nxjerrë në pah stile shumë të ndryshme të dy kandidatëve për president. Ata debatuan për pandeminë e koronavirusit, nominimin e një gjykatëse të re të Gjykatës Supreme, rendin dhe ligjin si dhe marrëdhëniet racore.

Trump dhe Biden gjatë debatit shumë shpesh i flisnin njëri-tjetrit dhe në një moment Bideni e quajti Trumpin një "gënjeshtar, një palaço", pastaj "këlysh i Putinit", si dhe në një moment i tha: "A do ta mbyllësh gojën, burrë?"

Trump, nga ana e tij, tha se "e majta radikale" e ka Bidenin të "mbërthyer përreth gishtave" dhe tha se djali i tij Hunter kishte përfituar në mënyrë të papërshtatshme gjatë punës në Ukrainë, duke shfrytëzuar lidhjen e babait të tij.

Akuzat e ndërsjella mes kandidatëve bëheshin aq shpesh sa që moderatori i debatit, Chris Wallace nga "Fox News", u shfaq i acaruar disa herë. Ai ishte veçanërisht i irrituar me Trumpin, duke iu lutur presidentit që të mos ndërpresë dhe duke i kujtuar atij se ekipi i fushatës kishte rënë dakord me rregullat e debatit.

Të dy kandidatët nuk ia shtrënguan dorën njëri-tjetrit në fillim të debatit, pasi ky akt tradicional u hoq nga plani për shkak të pandemisë së

koronavirusit. Përballja mes tyre u ndoq nga një audiencë në sallë prej më pak se 100 personash. Ngjarja u mbajt në mjediset e universitetit "Case Western" në qytetin Klivland të Ohajos.

Biden gjatë debatit e sulmoi Trumpin lidhur me trajtimin e pandemisë së koronavirusit, duke thënë se presidenti "priti e priti" për të vepruar dhe se ai "ende nuk ka një plan". Ai i tha Trumpit që të "dilte nga gracka e rërës" - duke iu referuar lojës golf të cilën e praktikon Trump - dhe të shkonte në Zyrën Ovale për të dalë me një plan dypartiak në mënyrë që t'i shpëtojë njerëzit nga pandemia.

Por, Trump iu përgjigj: "Ne kemi bërë një punë të shkëlqyeshme", duke shtuar, "por unë të them ty, Joe, ti kurrë nuk do të mund ta kishe bërë punën që ne bëmë. Nuk e ke në gjak këtë punë".

Trump përsëri sinjalizoi gjatë debatit se ai mund të mos pranonte një humbje në zgjedhje dhe kritikoi votimet e hershme dhe fletëvotimet me postë. Në të kaluarën ky lloj i votimit është praktikuar në Shtetet e Bashkuara pa probleme serioze. Trumpi këmbëngul se ato janë të ndjeshme ndaj mashtrimeve. Biden u bëri thirrje votuesve të votojnë "sido që të jetë mënyra më e mirë për ju", duke thënë se Trumpi "nuk do të jetë në gjendje t'ju ndalojë ta përcaktoni rezultatin e këtyre zgjedhjeve".

Kandidatët kaluan një pjesë të kohës duke debatuar mbi nominimin që Trump i bëri Amy Coney Barrett si gjyqtare



në Gjykatën Supreme për të zëvendësuar të ndjerën, Ruth Bader Ginsburg. Bideni dhe demokratët e tjerë e kanë kundërshtuar Trumpin për vendimin e ndërmarrë kaq pranë mbajtjes së zgjedhjeve. Por, Trumpi tha se republikanët kanë fituar zgjedhjet më 2016 dhe për këtë arsye kanë të drejtë të zgjedhin. Trumpi, gjithashtu, u deklarua për një raport hulumtues të publikuar nga gazeta "New York Times" në të cilin pretendohet se ai ka përdorur zbrazëtira ligjore për të paguar më pak taksa në të ardhurat personale në vitet e fundit. Trumpi këmbënguli se ai ka paguar "milionë" taksa dhe tha se të gjithë udhëheqësit e biznesit bëjnë të njëjtën gjë si ai "nëse nuk janë budallenj". Ai tha

se publiku do të njoftohet për kthimin e tij personal të taksave, por nuk do të tregojë kur do të ndodhë kjo.

Disa orë para debatit kandidatit demokrat, Joe Biden publikoi deklaratat e tij tatimore që tregojnë se ai dhe gruaja e tij Jill paguan më shumë se 346 000 dollarë taksa federale dhe pagesa të tjera për vitin 2019 me të ardhura prej gati 985 000 dollarësh. Kur gjatë debatit u hap tema për marrëdhëniet racore në Shtetet e Bashkuara, Trump anashkaloi një pyetje nëse ai ishte i gatshëm t'i dënonte supremacistët e bardhë dhe grupet ushtarake. "Unë do të thosha se pothuajse gjithçka që shoh vjen nga krahu i majtë, jo nga krahu i djathtë", u përgjigj Trump. "Unë jam i gatshëm të bëj gjithçka. Unë dua ta shoh

paqen", tha ai.

Bideni e akuzoi Trumpin për përdorimin e "githçkaje në përpjekje për të gjeneruar urrejtje dhe ndarje racore".

Trump ia përmendi Bidenit mbështetjen për një ligj kundër krimin sa ka qenë senator në vitet '90 dhe tha se Bideni i kishte trajtuar afro-amerikanët "gati më keq se çdokush në këtë vend".

Toni i ashpër gjatë debatit të parë, menjëherë ngriti pikëpyetje nëse dy debatet e tjera midis Bidenit dhe Trumpit do të zhvillohen ashtu siç është planifikuar.

Debati tjetër në kuadër të fushatës është midis kandidatëve për nënpresident. Nënpresidentit aktual Mike Pence dhe senatorja Kamala Harris do të debatojnë më 7 tetor. (rel)

Merkeli për pandeminë: Na presin muaj të vështirë

BERLIN, 30 SHTATOR - Gjermania do të përballlet me disa muaj të vështirë për shkak të koronavirusit, ka paralajmëruar kancelarja gjermane Angela Merkel. "Gjermania deri më tani ka kaluar pandeminë relativisht mirë falë sjelljes jashtëzakonisht të përgjegjshme të qytetarëve në muajt e fundit, por ne shohim tani që po vjen vjeshta, një fazë e vështirë është përpara", i tha Merkel parlamentit gjerman. Gjermania raportoi 1 798 raste të reja me koronavirus të mërkurën, treguan të dhënat e Institutit për Sëmundjet

Infektive "Robert Koch".

Të martën Merkeli diskutoi me udhëheqësit e 16 landeve për t'i fuqizuar masat kundër pandemisë. Kufizimet synojnë të shmangin "me çdo kusht" një izolim mbarëkombëtar, tha Merkel, duke shtuar se mbajtja në funksion e ekonomisë është një përparësi.

Numri i përgjithshëm i të infektuarve në Gjermani ka arritur në mbi 280 mijë, ndërsa mbi 9 mijë persona kanë vdekur. Ndër masat që parashohin autoritetet gjermane është kufizimi i numrit të personave në tubimet private dhe publike.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Llapi regjistroi humbjen e katërt rresht, '89-shi mposhti Prishtinën



Ballkani e ka marrë kryesimin në elitë pas fitores në stadiumin "Zahir Pajaziti" ndaj Llapit, ndërsa humbje kanë pësuar Prishtina nga Trepça '89 në "Riza Lushta". Drita në ndeshjen e parë në këtë kampionat mori tri pikët ndaj Besës së Pejës. Sot (e enjte) zhvillohet ndeshja e fundit për javën e katërt në mes të Drenicës dhe Gjilanit

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Skuadra e Ballkanit po tregohet e fortë në këtë kampionat, pasi sot e mposhti Llapin me rezultat bindës 1-3. Vetëm në pjesën e parë Llapi arriti të mbahet. Gjashtë minuta pasi filloi pjesa e dytë, Emini i vendësve e pengoi Prekazin në zonën e rreptësisë dhe gjyqtari akordoi penallti. Nga pika e bardhë i pagabueshëm ishte Mirlind Daku, i cili realizoi golin e shtatë personal. Pas një ore lojë, Daku doli edhe një herë në skenë dhe realizoi për 0-2, kurse i njëjti futbollist mori pjesë edhe në golin e tretë ku e shërbeu për mrekulli Blend Baftiun, i cili realizoi për 0-3. Ndërsa Arbnor Ramadani realizoi golin e nderit për Llapin nga gjuajtja e lirë (1-3). Llapi në tri ndeshjet e zhvilluara regjistroi tri humbje, kurse Ballkani e merr kryesimin me dhjetë pikë të grumbulluara. Rezultat befasues është regjistruar edhe në ndeshjen e zhvilluar në "Riza Lushta" në mes të

Trepçës '89 dhe Prishtinës, ku fitues dolën vendasit (1-0). Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse në minutën e 82-të Arbnor Muja realizoi nga penalltia. Prishtina në pjesën e dytë realizoi një gol, por ai u anulua për shkak të pozitës jashtë lojës. Pas javës së katërt, Trepça '89 ka grumbulluar gjashtë pikë, kurse Prishtina mbetet në kuotën e katër pikëve. Kampionia në fuqi e Superligës, Drita, e ka nisur në mënyrë të duhur edicionin e ri 2020/2021. Skuadra gjilanasë e mposhti Besën e Pejës me rezultat 3-1. Rexha shënoi pas njëmbëdhjetë minutave lojë, kurse mysafirët e barazuan rezultatit në minutat shtesë të pjesës së parë me golin e Salihut. Në minutën e 78-të, Hamdi Namani e rikthehu epërsinë e vendësve, kurse Rexha shënoi për 3-1. Drita mori tri pikët e para në ndeshjen e parë, pasi në tri ndeshjet e kaluara nuk luajti për shkak të pjesëmarrjes në garat ndërkombëtare, kurse Besa e regjistron edhe humbjen e katërt rresht pas rikthimit në Superligë.

SUPERLIGA		
Llapi - Ballkani		1-3
Trepça '89 - Prishtina		1-0
Drita - Besa		3-1
Arbëria - Feronikeli		0-0
Të enjten takohen: 15:00 Drenica - Gjilani		
Tabela		
1. Ballkani	4	10 pikë
2. Arbëria	4	8
3. Trepça '89	3	6
4. Feronikeli	4	5
5. Prishtina	3	4
6. Drenica	3	4
7. Gjilani	3	4
8. Drita	1	3
9. Llapi	3	0
10. Besa	4	0
Në xhiron e pestë takohen: Gjilani-Arbëria, Feronikeli-Drita, Ballkani-Drenica, Besa-Trepça '89, Prishtina-Llapi.		

SHKURT

Greza do të operohet sërish

Eros Greza ka sërish probleme me këmbën e majtë dhe duhet të operohet sërish. Lajmin e bëri të ditur klubi kroat Osijek në faqen zyrtare. Në qershor sulmuesi i kombëtares shqiptare u operua për herë të parë. Ai u kthye në stërvitje për fazën përgatitore dhe ishte pjesë e ekipit në katër ndeshjet e para të kampionatit dhe ndeshjen evropiane kundër Bazelit. Dhembja është shtuar dhe stafi mjekësor vendosi për një tjetër operim. Mendohet se Greza nuk do të luajë më për këtë vit, edhe pse nuk ka një datë zyrtare për rikthimin e tij në fushë.

Gavazaj largohet nga Kukësi, e ardhmja në Kosovë

Futbollisti Enis Gavazaj është larguar nga skuadra e Kukësit. Ai nuk bënte pjesë në planet e skuadrës shqiptare dhe e ardhmja e tij duket të jetë në Superligë të Kosovës. Skuadra që ka shfaqur interesim për futbollistin nga Prizreni është FC Prishtina. Nga Kukësi në këtë afat kalimtar është larguar edhe mesfushori Besar Musolli.

Milani dhe Ajaxi, në garë për Gjimshitin

AC Milan është në kërkim të një mbrojtësi për ta blinduar repartin e prapavijës. Emrat më të përfolur në ditët e fundit kanë qenë Tomiyasu dhe Nastasiq, por Paolo Maldini po sheh edhe për profile të tjerë futbollistësh. Sipas asaj që raporton "Tuttosport", kuqezinjtë kanë hedhur vështrimin edhe nga Berat Gjimshiti. Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë ka shkëlqyer në dy sezonet e fundit me berga-maskët, duke bërë paraqitje fantastike. Milani nuk është skuadra e vetme që ka shfaqur interes konkret, pasi në garë është edhe Ajaxi.

14 raste pozitive me Covid-19 te Genoa

Raundi i dytë i testimit ka konfirmuar 14 raste pozitive të koronavirusit te Genoa, të cilët presin vendimin e Serisë A për ndeshjen kundër Torinos. Klubi italian ka konfirmuar se raundi i dytë i testeve konfirmoi 14 teste pozitive gjatë fundjavës. Këtë mëngjes anëtarët e tjerë të ekipit dhe stafi mbërritën me makinë në terrenin e stërvitjes. Punonjësit dhe drejtuesit që u testuan të mërkurën, të gjithë kanë marrë rezultate negative për Covid-19. Genoa është duke pritur për vendimin e ligës në ndeshjen e planifikuar të luhet të shtunën kundër Torinos.

Drenica prezanton Miftarajn

SKENDERAJ, 30 SHTATOR - Mesfushori i njohur Diar Miftaraj është veshur kuqezi. Në fakt, futbollisti që edicionin e kaluar me plot sukses mbrojti ngjyrat e

Prishtinës është transferimi më i ri i Drenicës nga Skenderaj. Ish-futbollisti i Besës së Pejës është prezantuar në skuadrën kuqezi nga kryetari i klubit, Ilir Veliqi.

“Mesfushori me tipare mbrojtëse, Diar Miftaraj, është lojtari më i ri i Drenicës. Ish-lojtari i Prishtinës ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin dhe ka mbetur

vetëm kompletimi i dokumentacionit dhe lojtari do të jetë i gatshëm t’i ndihmojë ekipit që nga ndeshja me Gjilanin”, thuhet në njoftimin e Drenicës.



Ministrja Dumoshi priti në takim sportistët e verbër

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, priti sot në takim sportistët e verbër të cilët po zhvillojnë aktivitete në kuadër të Javës Evropiane të Sportit. Në takim ishte e pranishme edhe ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barisic, kryetarja e Komitetit Paraolimpik të Kosovës, Njomza Emini dhe administratorja e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovakisë në Kosovë, Eva Havasiova.

Ministrja Dumoshi u shpreh e lumtur që kjo javë sportive ka bërë që të përfshihen të gjithë me aktivitete dhe që lehtësimi i masave ndaj Covid-19 ka bërë të mundur që aktivitetet sportive të zhvillohen më lehtësisht. “Gjithëpërfshirja në aktivitete sportive për të gjithë në Kosovë është tepër e rëndësishme dhe i kontribuon një shoqërie demokratike të barabartë”, ka thënë ministrja Dumoshi. “Ju uroj për aktivitetin tuaj të shahut për të cilin keni një talent të shkëlqyer. Ju e keni përfaqësuar Kosovën në Kampionatin Botëror dhe ju keni sjell rezultate të mira. Edhe pse Kosova është një vend i vogël, ju e keni bërë të mundur që ajo të jetë në mesin e 20 vendeve të botës, e kjo është një arritje shumë e madhe për vendin, prandaj edhe mbështetja jonë për ju nuk do të mungojë”, ka shtuar Dumoshi.

Sporti i personave të verbër në Republikën e Kosovës është



organizuar nga Federata e Sportit për të Verbër, e cila është themeluar në vitin 2006 dhe përbëhet nga shoqatat komunale dhe ndërkombetare në tërë territorin e Kosovës. Sportistët e verbër zhvillojnë dy disiplina sportive goalball dhe shah. Në goalball organizohet liga që nga viti 2006 dhe reprezentacioni i goalballit të Kosovës e ka përfaqësuar Kosovën edhe në gara ndërkombetare në Suedi, Belgjikë dhe Slloveni. Në disiplinën e shahut, të verbrit e Kosovës në vitin 2017 kanë marrë pjesë në Olimpiadën Botërore të Shahut për të Verbër dhe kanë treguar sukses të kënaqshëm. Federata e Sportit për të Verbër është anëtare e Komitetit Paraolimpik të Kosovës prej vitit 2011, prej themelimit të këtij komiteti. Ndërkaq, kryetarja e Komitetit Paraolimpik të Kosovës, Njomza Emini, ka thënë se persona me

aftësi të kufizuara në Kosovë marrin pjesë në garat ndërkombetare. “Në Kosovë ka persona me aftësi të kufizuara, por që nuk i pengon aspak ata të jenë pjesë e garave ndërkombetare dhe kjo na lehtëson edhe më shumë punën neve si Komitet Paraolimpik me mbështetjen që kemi nga ministrja Dumoshi. Jemi të lumtur që e kemi menduar dhe realizuar aktivitetin ku të verbrit kanë marrë pjesë në Javën Evropiane të Sportit”, ka thënë Emini.

Kryetari i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Daut Tishuki, tha se “shahu ka avancuar shumë dhe ne jemi pjesëmarrës si në Olimpiadën Botërore të Shahut, po ashtu edhe në dy kampionate individuale botërore për të verbër në kategorinë e shahut dhe me përkrahje nga Ministria dhe Federata e Shahut kemi treguar rezultate të mira”.

Marr përgjegjësi nëse gabova, por e bëra për të mirën e klubit

Barcelonë, 30 shtator - Lionel Messi dëshiron t’i lërë prapa mosmarrëveshjet e verës me Barcelonën dhe këmbëngul se asnjëherë nuk ka menduar t’i shkaktojë dëme klubit katalonas. Muajin e kaluar Messi i bëri kërkesë Barcelonës ta aktivizojë një klauzolë në marrëveshjen e tij e me klubin, e cila do ta lejonte atë të largohej falas. Barcelona, megjithatë, u kundërpërgjigj fuqishëm, duke thënë se afati për ta aktivizuar atë klauzolë kishte mbaruar tashmë duke qenë se kërkesa duhej të bëhej në qershor dhe jo në gusht. Në vend se ta sfidojë Barcelonën në gjykatë, Messi vendosi në fillim të këtij muaji të heqë dorë nga kërkesa për largim dhe si pasojë do të



qëndrojnë në klub edhe në sezonin 2020/21. Messi ka hyrë në vitin e fundit të marrëveshjes me Barçën, prandaj e ardhmja e tij nuk është aspak e sigurt duke parë se si mllëfi i tij me klubin

katalonas e arriti pikën më të lartë. Në një intervistë të mërkurën për “Sport”, Messi i siguroi tifozët e Barçës se asnjëherë nuk e ka pasur për qëllim t’i ofendojë, duke këmbëngulur se gjithmonë e ka pasur në mendje interesin më të mirë të klubit. “Marr përgjegjësi për gabimet e mia dhe nëse ka pasur të tilla, i bëra vetëm për ta bërë Barcelonën më të mirë dhe më të fortë. Kam dashur t’u dërgoj mesazh tifozëve dhe të gjithë shoqërisë. Nëse në çfarëdo çasti, ndokush prej tyre u ofendua nga diçka që kam thënë apo kam bërë, mos ta ketë asnjë dyshim se gjithçka që kam bërë, gjithmonë e kam bërë duke menduar për më të mirën e klubit”, ka thënë Messi.

SHKURT

Rehabilitimi i Schumacherit do të vazhdojë në Spanjë

Shtatë herë kampioni i botës në Formula 1, ish-piloti gjerman Michael Schumacher, është transferuar nga shtëpia e tij në Zvicër në Majorka të Spanjës. Ai do ta vijojë periudhën e rehabilitimit në vilën me vlerë 40 milionë euro që bashkëshortja e tij Corina ka bërë tri vjet më parë nga presidenti i Real Madridit, Florentino Perez. Vila ku Schumacheri do të qëndrojë njihet me emrin si “Villa Yasmin”, e vendosur në breg të detit. Schumacheri është aksidentuar në dhjetor të vitit 2013 teksa ishte duke bërë ski në Maribel të Francës. Që prej asaj kohe nuk ka asnjë foto të pilotit dhe asnjë informacion rreth gjendjes së tij.

Serena Williamsi tërhiqet nga ‘French Open’

Tenistja Serena Williamsi është tërhequr nga turneu Grand Slam i tenisit “French Open”, pasi ka marrë një lëndim të tejtës së Akilit, raporton BBC. Williams 39-vjeçare, fituese e trefishtë e Grand Slamit që njihet ndryshe Roland Garros, ishte paraparë të luante sot kundër bullgares Tsvetana Pironkova. Amerikania Williams ka fituar 23 Grand Slam turne të tenisit në konkurrencë individuale dhe në Paris po synonte ta barazonte rekordin e Margaret Court prej 24 Grand Slameve.

Barkley huazohet tek Aston Villa

Ross Barkley ka kompletuar transferimin tek Aston Villa. Mesfushori i Chelsea do të huazohet për një sezon në klubin ku asistent është legjenda e Bluve, John Terry. Barkley nuk kishte vend në formacionin e Frank Lampardit, pas blerjeve që bëri klubi londinez në afatin kalimtar të verës. Kësisoj, zgjedhja më e mirë për të ishte për të kërkuar minuta në një klub tjetër, dhe ai zgjodhi Aston Villën.

Rafael: Van Gaal është njeriu më negativ me të cilin kam punuar

Ish-mbrojtësi i Manchester Unitedit, braziliani Rafael, ka dhënë një intervistë për “Sport”, ku ka kritikuar ashpër ish-trajnerin e tij, Louis Van Gaal. Sipas Rafael, Van Gaal është një nga njerëzit më të këqij me të cilët ka punuar gjatë karrierës së tij. “Nuk më pëlqen Van Gaal. Ditën e parë nuk më ka folur. Të dytën më ka thënë se mund të largohesha. Nuk kishte bërë akoma asnjë stërvitje kur ma tha dhe mua nuk më besohej. Kam provuar të luftoja për vendin tim. Kam qenë me të për një vit. Ishte shumë, shumë e vështirë. Është një nga njerëzit më të këqij me të cilin kam punuar ndonjëherë. Nuk i interesonte se si ishin personat, donte të mendonte vetëm për veten: ‘Jam kështu, më respekto dhe bëj atë që dua unë’, kështu fliste. Lojtarët lodhen nga një sjellje e tillë”, u shpreh Rafael.

Evra: Noel Le Gret i tha Deshampit, merri këta majmunë dhe shko në Afrikë

Ish-mbrojtësi i Manchester Unitedit, Patric Evra, ka thënë disa deklarata shokuese në lidhje me atë çfarë ndodhi te kombëtarja e Francës në vitin 2010. Sipas Evras, te Franca ka pasur shumë racizëm. “Jam i detyruar t’i përgjigjem Noel Le Gret (Presidenti i Federatës Franceze të Futbollit) pasi ai e di shumë mirë se çfarë ndodhte te ne. E di ju se sa letra me mesazhe raciste kemi marrë? Një herë ai i pati thënë trajnerit Deshamps në atë kohë që merri këta majmunë dhe shko në Afrikë. Po ne i kemi fshehur këto fakte, por unë kam parë disa. Madje shpesh na vinin dhe kuti të mbushura plot me jashtëqitje. E njëjta që ndodhte edhe kur hanim dreka apo darka me ekipin”, ka thënë Evra. “Ne të gjithë kishim vendet tona, por sa herë që vinte presidenti unë përfundojta në fund të tavolinës së bashku me Sagnan dhe Sakhon. Ai preferonte më mirë të ulej pranë dhe të dilte në foto me Hugo Lorisin dhe Laurent Koscielny sesa me ne”, ka deklaruar Evra.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera/Office of Prime Minister

Zyra për Çështje të Komuniteteve/Kancelarija za pitanja zajednica/Office for Community Affairs

SHPALLË

KONKURS

Programi i praktikës në institucionet e nivelit qendror dhe lokal

Zyra e Kryeministrit / Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZKM / ZÇK), zbaton projektin **KOS-18/0018 CS Support to the Office for Community Affairs/Office of the Prime Minister** si donacion i Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë. Projekti synon që të zhvillojë kapacitete në katër komuna në veri të Kosovës përmes pjesëmarrjes aktive dhe punës së këshilltarëve në ato komuna. Gjithashtu, ky projekt synon të inkurajojë punësimin e komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal përmes programit të praktikës dhe nismave të tjera të parashikuara nga ky projekt.

ZÇK, në bashkëpunim me Ambasadën e Norvegjisë, shpall konkurs për "**Programin e praktikës në institucionet publike në nivel qendror dhe lokal**", për studentët e vitit të fundit të studimeve themelore dhe master dhe për të diplomuarit e studimeve themelore dhe master nga radhët e komuniteteve jo shumicë (në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës), për të ndihmuar zhvillimin profesional të këtyre komuniteteve në Kosovë.

Zhvillimi profesional paraqet investim serioz dhe për këtë arsye, kjo fushë është përcaktuar si një qëllim i qartë që i referohet prioritetit përkatës strategjik të ZÇK-së. Me këtë program, do t'iu mundësohet pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë për të fituar përvojë pune profesionale me qëllim të lehtësimin të gjetjes së punës së qëndrueshme në të ardhmën. Gjithashtu, ZÇK dëshiron të nxisë rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve jo shumicë në institucionet publike.

Napomena: Duke pasur parasysh situatën aktuale me pandemin Covid-19 dhe se komunat, për shkak të madhësisë së tyre, nuk disponojnë me kapacitete të mjaftueshme për t'iu mundësuar praktikantëve kushtet e nevojshme për punë, i lusim praktikantët potencial që të kenë mirëkuptim nëse ne nuk do të jemi në gjendje që t'i vendosim ata në afërsi të komunës nga e cila vijnë, dhe në atë rast do t'iu ofrohen institucionet e nivelit qendror.

Pas përfundimit të programit të praktikës, të gjithë praktikantët të cilët kanë përfunduar me sukses programin do të marrin një certifikatë.

Procesi

Pas përfundimit të konkursit, ZÇK-ja, do të formojë, në përputhje me ligjin dhe procedurat, një komision për zgjedhjen e kandidatëve. Do të përzgjedhen 100 kandidatë, për të kryer stazhin në institucionet publike në nivel lokal dhe qendror.

Duke pasur parasysh që, për shkak të pandemisë Covid-19, në fuqi është ndalimi i tubimit të një numri të madh të njerëzve në hapësira të mbyllura, ZÇK në këtë raund nuk do të zbatojë test me shkrim për kandidatët. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të ftohen për intervistë në bazë të cilës do të kryhet përzgjedhja finale e praktikantëve.

Pas përzgjedhjes së kandidatëve për punë praktike, atyre do t'iu ofrohet kursi falas i gjuhës shqipe, respektivisht serbe. Kursi është i dizajnuar të zgjasë tre muaj gjatë praktikës dhe kandidatëve të cilët e përfundojnë me sukses do t'iu jepet një certifikatë.

Aplikacionet e kandidatëve që kanë marrë pjesë në raundet e mëparshme të programit të praktikës, të vitit 2015-2016 dhe 2018 -2019, nuk do të merren parasysh.

Kriteret e përgjithshme për aplikim

- Të jenë shtetas të Kosovës;
- Të jenë studentë në vitin e fundit të studimeve themelore ose master, të diplomuarit e studimeve themelore dhe master;
- Të jenë jo më të vjetër se 30 vjeç;
- Të kenë njohuri të një gjuhë zyrtare të Kosovës;

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. **Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës (serbisht / shqip), vetëm në mënyrë elektronike (nuk plotësohet me dorë), në formë të përmbledhur me të dhëna të sakta (që do të merret në konsideratë vetëm formulari i ZÇK);**
2. **Një kopje të letërnjoftimit / pasaportës të vlefshme të Kosovës;**
3. **Dëshmi e praktikës studentore ose kopje të diplomës;**

4. **Dëshmi mbi vijimin e kurseve dhe trajnimeve (nëse ka);**
5. **Një rekomandim nga një person i cili ju njih dhe me të cilin ju nuk jeni në lidhje familjare**
6. **Ese me temë: Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave dhe pozitës së komuniteteve jo-shumicë**

- Renditni institucionet e nivelit qendror dhe lokal që merren me të drejtat e komuniteteve - mandatin dhe mekanizmat e mbrojtjes
- Specifikoni të drejtat e diskriminimit pozitiv
- Sipas mendimit tuaj, cilat janë problemet më të mëdha të komuniteteve dhe si t'i zgjidhni ato?

Shënim: Eseci duhet të dërgohet ekskluzivisht në formë elektronike (word ose pdf), dhe duhet të përmbajë 250-500 fjalë. Kandidatët që nuk marrin më shumë se 10 pikë (maksimumi 20) nuk do të ftohen për intervistë.

Fondi i programit

- ZÇK-ja do të ndajë 90.000 euro nga fondi i alokuar nga Ambasada Norvegjeze, i cili synon të zhvillojë dhe mbështet komunitetet në fusha të ndryshme, duke përfshirë dhe punësimin. Ky konkurs do të përfshijë 100 praktikantë në të gjithë Kosovën dhe kompenzimi mujor për ta do të jetë 150 euro, bruto për person. Programi i praktikës do të zgjasë gjashtë (6) muaj.
- Fondi total për një praktikantë, për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh është 900 €.
- Përfituesit e fondeve, bazuar në fondin, duhet të kenë një llogari bankare të veçantë, para se ZÇK / ZKM të bëjnë transferin e fondeve. Pagesa do të bëhet në euro dhe transferimi bëhet vetëm përmes transaksioneve bankare.

Brenda 30 ditëve nga data e mbylljes së konkursit, ZÇK do të shqyrtojë aplikacionet e dorëzuara dhe do të njoftoj kandidatët që janë në listën e ngushtë, si dhe do t'iu ftoj ata në një test me shkrim. Vetëm kandidatët që e kalojnë testin do të ftohen për intervistë.

Formularin e aplikimit mund ta gjeni në : <http://www.zck-ks.net> ili www.kryeministri-ks.net

Afati i aplikimit fillon nga data e publikimit, **30.09.2020 dhe do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, deri më datë 15.10.2020 në ora 16:00.**

Kandidatët e interesuar mund të dërgojnë aplikacionet e tyre së bashku me të gjitha dokumentet shoqëruese, vetëm përmes emailit në **email adresë zck-kpz-grants@rks-gov.net. Aplikacionet e shkruara me dorë nuk do të merren parasysh.**

***Vërejtje: Të dorëzohen kopjet e dokumenteve të kërkuara, sepse dokumentet nuk do të kthehen.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
 OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

GJYKATA THEMELORE
 C.nr.607/2015
 Me dt.25.09.2020
 Mitrovicë

"GAZETA ZYRTARE" E REPUBLIKES SE KOSOVES

Ne bazë të nenit 83 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës kërkojmë të publikoni këtë,

SHPALLJE

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në qështjen juridike të paditësit: Besim (Ejup) Faszliu nga Mitrovica, Rr. "Mbreti Bardhyl" nr.16, të cilin sipas autorizimit e perfaqeson Av. Uvejs Gashi nga Mitrovica, kundër të paditurve: Murat Ibrahim, Abduni Mirexhije dhe Abdula Ibishi nga Mitrovica tani me adres të panjohur, baza e kontestit: vertetim pronësie në bazë të mbajtjes, në bazë të nenit 79, pika 3-a e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës të paditurve: Murat Ibrahim, Abduni Mirexhije dhe Abdula Ibishi nga Mitrovica: i caktohet perfaqesuesi i perkohshem Av. Festim Shala avokat në Mitrovicë.

Perfaqesuesi i perkohshem do të perfaqesoi të paditurit në këtë çështje juridike deri sa ata apo i autorizuari i tyre të paraqitet në këtë gjykatë.


GYATARI,
 Ragip Kadriu

Standard advertisement for local publication of local open tender procedures

Modern dairy farm 2019/413-190



Rudina D sh.p.k. intends to award a work contract for the action/grant "Modern dairy farm" (2019/413-190) located at the official address "Kujavca street, village of Llukac i thatë, 31000 Istog, Kosovo", with financial assistance from the European Union, represented by the European Union Office in Kosovo.

The tender dossier is available for inspection at the above mentioned address and in the email address: avdi.citaku@gmail.com or phone no.: [+383 49 263 011](tel:+38349263011)

The deadline for submission of tender is on 02.11.2020 at 14:00 hrs. at the following address: "Kujavca street, village of Llukac i thatë, 31000 Istog, Kosovo".

Any possible additional information or questions related to announced action to will be clarified in the tender dossier available in above-mentioned addresses, published email address or phone number.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

ATK, edhe me një shërbim të ri elektronik!

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se nga data 01 Tetor 2020 do të publikon versionin e ri të Sistemit Elektronik – EDI, përmes të cilit do të kërkohet plotësimi dhe freskimi i informatave të tatimpaguesit.

Shërbimi i ri elektronik për plotësimin dhe freskimin e informatave të tatimpaguesit është funksionalizuar në sistemin elektronik EDI, dhe është në dispozicion për tatimpaguesit, të cilët do të shfrytëzojnë sistemin EDI.

Përmes këtij shërbimi, tatimpaguesi është i obliguar për përditësimin e informatave të tij, me qëllim që Administrata Tatimore të ketë informatat e sakta për të komunikuar me tatimpaguesin.

Më konkretisht përmes shërbimit "Plotësimi dhe freskimi i informatave të tatimpaguesit", përveç informatave të cilat merren nga regjistri i tatimpaguesve përmes Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), si dhe Institucione tjera, tatimpaguesi do të jetë i obliguar për të ofruar edhe informata shtesë, si:

- E-mail i biznesit;
- Telefoni i biznesit;
- Mbajtësi i librave / Kontabilistit;
- Telefoni i mbajtësit të librave / Kontabilistit;
- Email adresa e mbajtësit të librave / Kontabilistit;
- Llogaria bankare e biznesit, etj.

Për plotësimin e saktë të informatave të tatimpaguesit, ATK ka përgatitur "Udhëzuesin për plotësimin e informatave në Profilin e tatimpaguesit", të cilin do ta gjeni në dritaren përkatëse ku edhe bëhet plotësimi i të dhënave, andaj ju sugjerojmë që ta shfletoni udhëzuesin paraprakisht.

ATK mban premtimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!
Administrata Tatimore e Kosovës



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. - Prishtinë, me datë 01.10.2020, SHPALLË:

KONKURSIN PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit (1 pozitë):

II. Numri i referencës: NPL -D.T. 01/10/20/3:

III. Detyrat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP. ZPP përveç obligimeve tjera ka përgjegjësi të vijim: a) Në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetor të prokurimit. Kur është e mundur siguron që artikujt e përdorimit të zakonshëm janë konsoliduar; b) Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrë më ekonomike, efektive dhe të shpejta; c) Për aq sa mundet, siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë; d) Këshillon njësitë kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit; e) Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njesive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, specifikimet, të Paramasat dhe Paralogaritë dhe vizatimet; f) Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit; g) Rekomandon përberjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve; h) Partecipon në Negocime të Tenderëve dhe siguron rezultate të drejta; i) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues; j) Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar; k) Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht; l) Kur ndodhin mosmarrëveshje, dëme në mallra, dorëzime të tepërta ose të mangëta, dështim në performancë ose komplikime tjera relevante, ruan të gjitha komunikimet dhe dëshmitë relevante të pranuar; m) Përcjell dështimet e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave; n) Prodhon një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara. nj) Kryen punë dhe detyra tjera të urdhëruar nga Mbikëqyrësi.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Letër motivuese;
- Dëshmi për shkollimin e notizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës nga (punëdhënësit, nga Trusti Pensional dhe nga ATK-ja);
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera;
- Certifikata e mjekut;
- Certifikata se keni zotësi të veprimit;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Diploma e notizuar e kualifikimit superior;
- Certifikatë valide, bazike apo të avancuar të prokurimit e notizuar;
- Tre (3) vjet përvojë pune në vendin e punës, zyrtar përgjegjës i prokurimit;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;
- Njohuria obligative e kompjuterit.

VI. Kohëzgjatja e emërimit;

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbylljes së konkursit;

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendari dhe atë nga data e publikimit.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim;

- Aplikacionet për punësim mund të merren fizikisht në zyrën e Departamentit të Administrimit Qendror dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim;

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Leonard Lleshdedaj shpall te pa vlefshme dëftesën e plot te Sh.F.M.U." At Gjergj Fishta " ne Bishtazhin KK Gjakovë.
- ▶ Bylbyl Muhadri shpall te pa vlefshme dëftesën e plot te Sh.F.M.U."Durak Ahmeti " nga kl I- VIII ne Damjan KK Gjakovë.
- ▶ Drilona Mici shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.
- ▶ Granit Oseku shpall te pa vlefshme certifikatën e testit maturës te Sh.M.Ekonomike "Kadri Kusari" ne Gjakovë.
- ▶ Fekri Hoxhaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Lulzim Raduni shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Ibrahim Fehmiu" Arbanë.
- ▶ Remzije Gashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Arianit Elshani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- ▶ Sherif Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Fadil Hisari" Prizren.
- ▶ Fitim Bajraktari shpall të pavlefshme ID kartelën e lëshuar nga kolegji i Biznesit.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë.
Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

